

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6950
E shtunë, 22 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

AAK-ja dorëzon në
Gjykatën Kushtetuese
Ligjin për Pagën
Minimale | PAGE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



OPOZITA KËRKON LLOGARI NGA BISLIMI: DIALOGU KA DEGRADUAR, VENDI TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA



Raportimi i zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi në Komisionin për Integritet Evropian ka dështuar të mbahet të premtën. Sipas opozitës, mbledhja ka dështuar të mbahet për

shkak se nuk ka qenë zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, mirëpo këshilltari i Besnik Bislimit, Klisman Kadiu ka deklaruar se mbledhja ka dështuar për shkak të kuorumit. Anëtarët e Komisionit për

Integritet Evropian nga radhët e opozitës kanë theksuar në një konferencë për medie se skandalet e qeverisë Kurti janë të panumërta dhe se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja

AKTUALE




KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATON
LIGJET QË I KUNDËRSHTONTE
OPOZITA | F. 3

HARADINAJ PYET PDK-NË DHE
LDK-në: SI SHKOHET NË ZGJEDHJE,
OSE SI GJENDET RRUGA E TRETË
PËR TË DALË NGA KJO GJENDJE? | F. 5


KUVENDI HAP DYERT PËR
BASHKADHETARËT MË 24 DHE 25
KORRIK | F. 7

EKONOMI



KOMPANITË MILIONËSHE QË PO I
MBAJNË TË RINJTË NË KOSOVË | F. 8

SPORT



JUNIKU DHE PEJA E MBËSHËTTIN
FUQISHËM ROBIN KRASIQIN | F. 10



**KURTI: KOSOVA I KA
PLOTËSUAR KËRKESAT
LIGJORE PËR T'U
BËRË PJSË KËSHILLIT
TË EVROPËS** | PAGE 3

**VERIFIKIMI
I STATUSIT TË
VIKTIMAVE TË
PËRDHUNIMIT
'NUK DUHET TË
KETË' AFAT** | PAGE 7



RENOVA
Miqedoni
Xhupçiqiç - Tetovë
Gurëz-Perizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300-309-44 487 029
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
838 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERLABIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.p.A.
DESA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa" d.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Greqia që pesë ditë fytafyt me zjarret

ATHINË, 21 KORRIK - Greqia u përpoq të frenonte një zjarr në perëndim të Athinës, i cili dogji tokën pyjore për të pestën ditë të premtën, pasi një tjetër valë nxehtësie goditi vendin.

Zjarrfikësit, të mbështetur nga avionë që bartin ujë dhe me ndihmë nga personeli shtesë nga Qiproja, Franca, Izraeli dhe Italia, u përpoqën ta kontrollonin zjarrin që shpërtheu në zonën më të gjerë të Athinës të hënën, duke shkatërruar shtëpi dhe duke detyruar evakuime të banorëve. “Ne po vazhdojmë të luftojmë zjarrin në perëndim të Athinës. Po i frikësohemi rindezjes së tij”, tha një zyrtar i zjarrfikësve për agjencinë e lajmeve

“Reuters”.

Mbi 100 shtëpi dhe biznese janë dëmtuar rëndë nga ky zjarr dhe një tjetër pranë Athinës, të cilin autoritetet arritën ta shuajnë më herët gjatë javës.

Qeveria njoftoi të premtën se do të ndajë ndihma për familjet e prekura, duke përfshirë ndihmën financiare dhe subvencione për shtëpitë me qira.

Dy zjarre të tjera në pyje në ishullin Rodos dhe në lagjen Lakonia në Greqinë jugore u vunë nën kontroll të premtën. Ministri për Krizat Klimatike, Vasilis Kikilias, u bëri thirrje njerëzve të qëndrojnë vigilentë.

Reziku i zjarreve në ditët në



vijim do të mbetet i lartë dhe parashikohet vapë e mëtejshme. “Po kalojmë një periudhë shumë të vështirë treditore, të premtën, të shtunën dhe të dielën, me kushte ekstreme të motit dhe temperatura shumë të larta të përcjella me erëra të forta”, tha ministri, duke shtuar se pas një pushimi të shkurtër, nga mesi i javës së ardhshme parashikohet një tjetër vapë.

Me temperaturat që priten të arrijnë 45 gradë celsius të shtunën dhe të dielën, Ministria e Kulturës tha se të gjitha vendet arkeologjike, përfshirë monumentin e Akropolit, do të mbyllen mes orës 12 dhe 17:30.

Mijëra izraelitë marshojnë kundër projektligjit për gjyqësorin

JERUSALEM, 21 KORRIK - Mijëra izraelitë u bashkuan në një marshim nga Tel Avivi në Jerusaleem të premtën, në shenjë proteste pasi kryeministri Benjamin Netanyahu është zotuar se do të shtyjë përpara një projektligj që synon ta kufizojë autoritetin e Gjykatës së Lartë. Protesta filloi me qindra demonstrues, por me kalimin e ditës numri u rrit në mijëra, me izraelitë nga rajone të ndryshme që u bashkuan. Marshimi mbuloi një distancë prej rreth 70 kilometrash dhe shërbeu si një protestë e fuqishme kundër asaj që shumë e konsiderojnë si një nga qeveritë më të djathta të historisë së Izraelit.

Protestuesit kanë planifikuar të kalojnë natën në një kamp në Shohesh, rreth 18 kilometra nga Jerusalemi, përpara se të nisen



në drejtim të parlamentit të Izraelit të shtunën, ditën e shenjtë hebraike të Shabatit.

Kjo protestë vjen vetëm një ditë pasi Netanyahu deklaroi vendosmërinë e tij për ta çuar

përpara projektligjin.

Pavarësisht prej përballjes së kundërshtimit nga protestuesit, rritjes së numrit të rezervistëve ushtarakë që dezertojnë dhe apeleve nga presidenti i ShBA-së, Joe Biden për ta rishqyrtuar planin, Netanyahu këmbëngul ta vazhdojë planin.

Ligjvënësit priten të votojnë të hënën këtë projektligj, i cili do t'i kufizojë kompetencat mbikëqyrëse të Gjykatës së Lartë duke kufizuar atë që t'i rrezojë vendimet që i konsideron “të paarsyeshme”.

Netanyahu dhe aleatët e tij - një grumbullim partish ultranacionaliste dhe ultra-ortodokse - thonë se plani është i nevojshëm për të frenuar atë që ata i konsiderojnë fuqi të tepërta të gjyqtarëve të pazgjedhur nga populli.

Kritikët thonë se legjislacioni do ta përqendrojë pushtetin në duart e Netanyahu dhe aleatëve të tij të ekstremit të djathtë dhe do ta minojë sistemin e kontrollit dhe ekuilibrit të vendit.

Plani për rishikimin e sistemit gjyqësor të Izraelit u njoftua menjëherë pasi Netanyahu mori detyrën si kryeministër pas zgjedhjeve parlamentare të nëntorit.

Presidentët e universiteteve të mëdha izraelite thanë se do të zhvillonin një grevë të dielën për të protestuar ndaj projektligjit, njoftuan mediet lokale.

Mjekët mbajtën një “grevë paralajmëruese” dyorëshe të mërkurën për të protestuar kundër tij. Ata u zotuan për masa më të ashpra nëse projektligji votohet.

Putini, Polonisë: Çdo agresion kundër Bjellorusisë është sulm ndaj Ruisë

MOSKË, 21 KORRIK - Presidenti rus Vladimir Putin e ka akuzuar të premtën shtetin anëtar të NATO-s, Poloninë, se ka ambicie territoriale në ish-Bashkimin Sovjetik.

Mes të tjerash, Putini ka thënë se secili agresion kundër Bjellorusisë do të konsiderohet sulm ndaj Ruisë, dhe se Moska do ta mbronte shtetin fqinj me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion.


Komiteti i Sigurisë në Varshavë ka marrë vendim të mërkurën për t'i dërguar disa njësite ushtarake në lindje të Polonisë pasi anëtarë të grupit mercenar rus Wagner kanë arritur në Bjellorusi, ka thënë

agjencia shtetërore e lajmeve PAP, duke e cituar sekretarin e komitetit.

Të mërkurën shefi i Wagnerit, Yevgeny Prigozhin, është parë në një video duke i mirëpritur luftëtarët e tij në Bjellorusi, duke u thënë se nuk do të marrin më pjesë në luftën në Ukrainë, mirëpo do të përgatiten për Afrikë teksa e stërvitin ushtrinë bjelloruse.

Prigozhini ka thënë se Wagneri, i cili ka zhvilluar luftë të ashpër në qytetin ukrainas të Bahmutit, është forca luftarake më efektive e Ruisë.

Mirëpo përplasjet e shpeshta me



udhëheqësinë ushtarake në Moskë kanë rezultuar me nisjen e një rebelimi nga ana e tij katër javë më parë.

Rebelimi ka përfunduar me një marrëveshje që parasheh largimin e Wagnerit në Bjellorusi, apo anëtarësimin e pjesëtarëve të grupit në ushtrinë ruse.

Putini ka thënë se ka raportime në media se një njësit polakolituanez do të shfrytëzohet për operacionet në perëndim të Ukrainës - pjesë të së cilës dikur i kanë takuar Polonisë - dhe që ta pushtojë territorin atje. “Dihet mirë se ata ëndërojnë edhe tokën bjelloruse”, ka thënë ai, pa ofruar ndonjë të dhënë.

Polonia, në anën tjetër, ka thënë se nuk ka ambicie territoriale në Bjellorusi.

Kurti: Kosova i ka plotësuar kërkesat ligjore për t'u bërë pjesë e Këshillit të Evropës

Të premten është mbajtur mbledhja e parë e Grupit Koordinues për Anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, në të cilën kanë marrë pjesë edhe kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla. Kurti ka thënë se Republika e Kosovës i ka plotësuar kërkesat ligjore dhe standardet demokratike për t'u bërë anëtare e Këshillit të Evropës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeminstren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, morën pjesë të premten në mbledhjen e parë të Grupit Koordinues për Anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se si organizata më e vjetër panevropiane, Këshilli i Evropës, ashtu sikurse edhe shteti ynë, mishërojnë vlerat dhe standardet më të larta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. "Anëtarësimi në Këshillin e Evropës mundëson qasjen në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe mekanizmat e tjerë mbrojtës të Këshillit të Evropës", u shpreh kryeministri, derisa theksoi se kjo forcon edhe më

shumë mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve tanë pa dallim etnie.

Ai tha se Republika e Kosovës ka plotësuar edhe kërkesat ligjore edhe standardet demokratike për t'u bërë anëtare e Këshillit të Evropës. Kryeministri Kurti shtoi se do të bashkëpunojë ngushtë me Asambleen Parlamentare të Këshillit të Evropës përgjatë tërë procesit të vlerësimit dhe se ka besim se ky Grup Koordinues ndërinstitucional, nën udhëheqjen e zëvendëskryeminstri Ahmeti, do të punojë me përkushtim në funksion të mbarëvajtjes së vizitave fakt-mbledhëse si dhe në adresimin e të gjeturave dhe rekomandimeve nga raportuesit. Zëvendëskryeminstrija, njëherësh ministrija e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, vuri në theks se etapa e parë e anëtarësimit në Këshillin e Evropës ka qenë shumë e rëndësishme dhe nuk do të bëhej pa bashkëpunim të katër institucioneve për ta



kaluar fazën e parë të mbushur plot sfida. "Si vendi më demokratik në rajon, si një vend i cili është shembull në përfaqësimin e vlerave të cilat janë baza mbi të cilën është krijuar Këshilli i Evropës, mendojmë që Kosova dje do të duhej të ishte anëtarësuar në Këshillin e Evropës, madje shumë vjet më parë", ka pohuar ministrija Gërvalla,

duke shtuar se sa më shumë që punojmë së bashku, aq më shpejt do të arrijmë ta festojmë anëtarësimin e plotë. Grupi Koordinues do të ketë një rol tejet të rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit të brendshëm, si dhe në ofrimin një pasqyre sa më të saktë dhe koherente të situatës në Kosovë lidhur me të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe

demokracinë. Në këtë mbledhje të parë të pranishëm ishin përfaqësues politikë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe zyrtarë të tjerë të lartë shtetërorë dhe institucionale.

Kuvendi i Shqipërisë miraton ligjet që i kundërshtonte opozita

TIRANË, 21 KORRIK - Pas rreth 17 orësh me debate dhe tensione, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin për "kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të tij për qëllime mjekësore dhe industriale".

Seanca maratone e nisi punimet paraditen e së enjtes dhe i mbylli në orët e para të mëngjesit të së premtes. Sesiion parlamentar u mbyll duke miratuar edhe disa nisma të tjera që janë kundërshtuar nga opozita dhe grupet e interesit.

Kuvendi miratoi edhe Ligjin për "trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë".

Ligji i vë studentët para zgjedhjes që të bëjnë 5 vjet punë të detyrueshme në Shqipëri pas studimeve, ose të paguajnë tarifën shumë të larta studimi nëse nuk e pranojnë këtë kusht.

Ligji që lejon kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale u miratua me 69 vota për, 23 kundër dhe 3 abstenime. Deputetët e Partisë Socialiste në pushtet, Fatmir Xhafa, Pandeli Majko dhe Erjon Braçe, abstenuan.

Në fjalimin që mbajti në Kuvend, deputeti Fatmir Xhafa tha se shoqëria shqiptare nuk është gati për një nismë të tillë. "A është gati shoqëria shqiptare për këtë projektligj me rreze të mëdha sociale? Unë mendoj se kjo është qasje e gabuar. Ky është një biznes që vret. është një hap i parakohshëm për Shqipërinë", tha Xhafa, deputet dhe ish-ministër i Brendshëm.

Ligji u mbrojt nga ministrija e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, e cila tha se do të ngrihet një agjenci për kontrollin e kultivimit dhe prodhimit të kanabisit, si dhe për dhënien e licensave për eksport.

Sipas qeverisë shqiptare, me këtë ligj synohet rregullimi dhe mbikëqyrja e kultivimit,



përpunimit dhe eksportimit të kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale. Qeveria thotë se kjo nismë do ta rrisë ekonominë

e vendit. Deputetët e opozitës në Kuvend shprehën dyshime pse ligji u miratua me shpejtësi në

komisionet parlamentare nga socialistët, ndërsa nuk ka një studim mbi përfitimet ekonomike.



Opozita kërkon llogari nga Bislimi: Dialogu ka degraduar, vendi të shkojë në zgjedhje të reja

Raportimi i zëvendëskryeminitrit Besnik Bislimi në Komisionin për Integritim Evropian ka dështuar të mbahet të premtën. Sipas opozitës, mbledhja ka dështuar të mbahet për shkak se nuk ka qenë zëvendëskryeminitri Besnik Bislimi, mirëpo këshilltari i Besnik Bislimit, Klisman Kadiu ka deklaruar se mbledhja ka dështuar për shkak të kuorumit. Anëtarët e Komisionit për Integritim Evropian nga radhët e opozitës kanë theksuar në një konferencë për medie se skandalet e qeverisë Kurti janë të panumërta dhe se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 KORRIK - Anëtarët e Komisionit për Integritim Evropian nga radhët e opozitës kanë mbajtur konferencë për medie të premtën pas dështimit të raportimit të zëvendëskryeminitrit Besnik Bislimi në këtë komision, i cili ishte ftuar të raportonte në lidhje me dialogun.

Këshilltari i Besnik Bislimit, Klisman Kadiu, në "Facebook" ka shkruar se mbledhja ka dështuar të mbahet për shkak se nuk ka pasur kuorum. "Mbledhja e paraparë për raportim të zëvendëskryeminitrit Bislimi para Komisionit Parlamentar për Integritim Evropian nuk u mbajt për shkak se nuk pati kuorum. Jo sepse nuk shkoj zëvendëskryeminitri Bislimi. Ai pikërisht

nuk ishte prezent, sepse nuk kishte kuorum", ka pohuar ai. Më tutje, ai ka shtuar se "zëvendëskryeminitri Bislimi nuk ka refuzuar asnjëherë të raportojë në Komisionin për Integritim Evropian". Deputetja e PDK-së, Blertha Deliu-Kodra, e ka kritikuar zëvendëskryeminitrin Besnik Bislimi për mosraportim. Sipas saj, skandalet e qeverisë janë të panumërta dhe se vendi duhet të shkojë në zgjedhje. "Njeriu dy i kësaj qeverie prej marrëzisë dhe skandaleve sot nuk ishte për të raportuar, sepse e gjithë ajo që ka bërë kjo qeveri janë skandalet e panumërta. Sot Kosova është më keq se kurrë nga brenda, më e izoluar se kurrë nga jashtë. Në seancën e fundit kemi parë që numri dy ushtron dhunë ndaj deputetëve. Ata sa më herët duhet t'i lirojnë pozitën dhe vendi

të shkojë në zgjedhje e të kthehet legjitimiteti te qytetarët", ka thënë ajo. Në sallën ku ishte paraparë të mbahet mbledhja e Komisionit për Integritim Evropian, deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Blertha Deliu-Kodra, ka vendosur disa fotografi ku shihet Bislimi duke e gjuajtur me shishe deputetin e PDK-së, Mërgim Lushatakun. Deputetja e LDK-së, Rrezarta Krasniqi, ka thënë se edhe përkundër konfirmimit se do të marrë pjesë në mbledhjen e këtij komisioni, Besnik Bislimi nuk kishte ardhur, madje kishin munguar edhe deputetët e opozitës. "Sot e kam thirrur takimin. Zëvendëskryeminitri dje na ka njoftuar që nuk vjen. Qëllimi u bë i ditur sot se nuk erdhën as deputetët e opozitës. Ne e kemi thirrur për të raportuar

për sanksionet dhe takimin në Bratislavë, një takim që nuk duhet të ndodhte atje, por në Bruksel", ka thënë Krasniqi. Kritika për mosraportim të Bislimit pati edhe deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj. "Kjo është qeveria më jotransparente. Kjo qeveri është e obliguar që përmes një rezolute të diskutojë për dialogun. Po e shihni se kjo qeveri po ikën nga deputetët", ka thënë deputetja Kadrijaj. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka reaguar pas dështimit të raportimit të zëvendëskryeminitrit Besnik Bislimi në Komisionin për Integritim Evropian. "Nuk është hera e parë që kryenegociatori i Kosovës për dialog nuk raporton në komisione të Kuvendit. Raportimi i qeverisë në Kuvend për dialogun nuk është në vullnetin e saj, por është obligim kushtetues. Nuk mund t'i iket kësaj përgjegjësie", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka thënë se "është për keqardhje degradimi i dialogut nga takimet e nivelit më të lartë në Uashington e Bruksel për Marrëveshje finale, ligjërishit e obligueshme, për njohje reciproke dhe normalizim të

marrëdhënieve', në dialog nëpër hotele të plazheve, në Bratislavë e në Ohër për marrëveshje të ndërmjetme që e lënë problemin hapur për dhjetë vitet e Bislimit pati edhe deputetja e Zëvendëskryeminitrit Besnik Bislimi më 19 korrik ka qëndruar në Bruksel. Ai ka marrë pjesë në raundin e radhës të negociatave të nivelit të kryenegociatorëve në kuadër të procesit të dialogut. Ai ka pasur takim bilateral me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për Dialogun Kosovë - Serbi dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajçak. Në këtë takim janë diskutuar katër tema kryesore: Plani i sekuencimit të zbatimit të Marrëveshjes Bazike; Deklarata për Personat e Pagjetur; Termat e referencës për Komitetin e Përbashkët i cili merret me monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes Bazike; dhe Energjia. I pyetur nga gazetarët sa iu përket masave ndëshkuese të BE-së, ai ka thënë se: "Dakordimi (i Bratislavës) ka të bëjë me zbatimin e kërkesave të BE-së dhe u përgjigjet këtyre kërkesave. Për ne ka qenë e qartë që nga fillimi që kjo është rruga për heqjen e masave

Haradinaj pyet PDK-në dhe LDK-në: Si shkohet në zgjedhje, ose si gjendet rruga e tretë për të dalë nga kjo gjendje?

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se sot është shtuar numri i atyre që besojnë që Kurti dhe qeveria e tij janë fatkeqësi për Kosovën. Sipas tij, një shumicë kritike pajtohet se është e nevojshme që sa më parë të dilet nga kjo gjendje. "Njëra parti kërkon zgjedhje për të ndalur këtë të keqe që po i bëhet vendit, ndërsa partia tjetër është në kërkim të një rruge të re, po ashtu për të dalë nga kjo gjendje. Ne si Aleancë kemi ofruar një model se si të dilet nga situata e krijuar, që është mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë, si mjet mbase tash për tash i vetmi, për ta ndaluar degradimin e mëtejshëm që po i bëhet vendit. Në fakt edhe njëra edhe tjetra parti opozitare, po e kërkojnë të

njëjtën gjë që e kemi kërkuar edhe ne, por nuk po e shohin mënyrën se si realizohet kjo!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ai ka parashtruar edhe një pyetje për PDK-në dhe LDK-në. "Pyetja ime është, si shkohet në zgjedhje, ose si gjendet rruga e tretë për të dalë nga kjo gjendje? Ata presim kryeministrin që ta dorëzojë me vullnet mandatin e tij, gjë e cila duket e pamundshme, apo të presim të ndodhë ndonjë mrekulli vetvetiu? Prandaj partitë tjera opozitare, nëse janë të sigjerta në qëndrimin e tyre se kjo qeveri duhet ndalur me çdo kusht sepse po e shkatërron vendin, atëherë duhet ta kuptojnë se mocioni i propozuar prej nesh, është rruga e vetme, rrjedhimisht edhe ta mbështesin", ka theksuar Haradinaj.



AAK-ja dorëzon në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Pagën Minimale



PRISHTINË, 21 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka dorëzuar të premtën në Gjykatën Kushtetuese kërkesën lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e përfutimit në lartësi të pagës minimale. "Së bashku me këshilltaren e grupit, znj. Fixhrije Dragaj, sapo dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën tonë lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e përfutimit në lartësi të pagës minimale. Synimi ynë është që me rrugë kushtetuese të ndalim një padrejtësi të madhe rreth Pagës Minimale", ka thënë Tahiri, duke treguar se për këtë ligj disa palë nuk janë konsultuar. "[1] Këshilli Ekonomik Social i cili asnjëherë nuk është konsultuar. [2] Diskriminimi i

palëve të cenueshme dhe [3] Lidhjet me veteranët e UÇK-së, rast ky që është eklatant dhe që lidhet me vlerat që kjo kategori përfaqëson", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se pret që Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë kërkesën e tij. "I bëj pyetje Kurtit të na tregojë se kush e ka sot pagën 260 euro, ky ligj që është miratuar nuk ka asnjë impakt në terren. Është një mashtrim i radhës", ka thënë Tahiri, duke shtuar se presin nga Kushtetuesja që ta vlerësojë dhe që ky rast do t'i thyejë dy padrejtësi. "Padrejtësia e parë lidhet me mashtrimin flagrant të shumës së pagës minimale, të na tregojë se kush e ka pagën 260 euro, pra ky ligj nuk ka asnjë impakt në terren, sepse sot nuk ka asnjë pagë nën 260 euro në sektorin privat. E dyta lidhet me dinjitetin e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së dhe për kategoritë e cenueshme siç janë të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët", u shpreh Tahiri.

ndëshkuese ndaj Kosovës dhe është habi që ende nuk kemi një letër shpjeguese nga ana e z. Borrell që kërkon heqjen e masave nga ana e Komisionit Evropian". Bislimi ka thënë se Marrëveshja Bazike duhet të zbatohet në plotni. "Ne kemi kërkuar që të ketë qartësim të plotë të hapave në mënyrë që

të respektohet vetë kriteri i dhënë nga BE-ja ku thuhet që zbatimi duhet të ketë një mënyrë konsekuente ku Kosova bën diçka e Serbia bën diçka. Për çdo masë, për çdo veprim që kërkohet nga Kosova, ne kemi kërkuar të dimë se cili është kundërveprimi nga ana e Serbisë dhe mendoj se do të jetë problematike për palën serbe të

argumentojë se ata nuk duan të zbatojnë ndonjë pjesë të marrëveshjes ose duan që pjesë kryesore të marrëveshjes t'i zhvendosin për në fund, për arsye se kriteri i veprimeve ku të dyja palët bëjnë diçka duhet të respektohet në plotni", është shprehur zëvendëskryeministri Bislimi. Kuvendi i Kosovës më 13 korrik

u shndërrua në një vend përleshesh fizike, es deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe anëtarëve të Qeverisë së Kosovës që drejtohet nga Albin Kurti. Përleshjes i paraprinë akuzat e ashpër rreth një audio-incizimi, në të cilin Mimoza Kusari-Lila, kryetare e grupit parlamentar të partisë në pushtet, Lëvizjes

Vetëvendosje (LVV), u dëgjua të pohonte se kishte komunikuar me nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoičiq, vitin e kaluar. Partitë opozitare reagoan ashpër ndaj qeverisë pas publikimit të audio-incizimit. Nga LV-ja, para dhe pas ardhjes në pushtet, Radoičiq është cilësuar kriminel që punon kundër shtetit të Kosovës.



Rama e nderon me 'Çelësin e Qytetit' ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka mirëpritur në takim ambasadorin e

Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl. Për angazhimin dhe kontributin e vazhdueshëm për forcimin e

marrëdhënieve në mes të shteteve tona dhe në shenjë nderimi, Rama i dhuroi "Çelësin e Qytetit".

Totaj: Sollëm përvojën amerikane të bashkëpunimit komunë - qytetarë

PRIZREN, 21 KORRIK - Promovohet nisja e buxhetimit me pjesëmarrje "Paratë tona, idetë tona, Prizreni ynë", të implementuar për herë të parë nga komuna e Prizrenit në tri lokacione: Zhur, Lagjen Kurrillë dhe Reçan; me nga dy takime në secilin vend. Prizreni është në mesin e komunave të para që ka nisur zbatimin e një modeli shumë të përhapur në botë, inspirim nga ShBA-ja, ku qytetarët vetë propozojnë, vetë votojnë idenë më të mirë dhe në fund komuna e financon projektin më të votuar. "Jam i lumtur që si kryetar po e zbatojmë për herë të parë një praktikë amerikane të re të bashkëpunimit me qytetarët, për ta rritur sa më shumë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje. Falënderoj

veçanërisht USAID-in - Kontrata Sociale, të gjitha organizatat, qytetarët, veçmas përfaqësuesit e tri vendbanimeve që ishin pjesë e kësaj nisme", u shpreh me këtë rast kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj. Ndarja e një shume të caktuar për këto projekte do të futet në buxhetin e komunës për vitin 2024, me ç'rast duhet votuar në Asambleenë Komunale, ndërsa me realizimin e suksesshëm të kësaj nisme do të rritet edhe më shumë buxheti vitin e ardhshëm për projekte të këtitilla. Ushtruesi i detyrës së drejtorit, Sean MacLeay, the USAID Democracy and Governance Acting Office Director, ka përgëzuar komunën e Prizrenit për gatishmërinë e të qenit sa më afër qytetarëve dhe për realizimin efikas të këtij pilot projekti.



Hiqet guri përkujtimor i nënës që e dogji veten pasi i varrosi eshtrat e bijve të vranë nga forcat serbe

GIJAKOVË, 21 KORRIK - Guri përkujtimor i Pashkë Markut (nënës që dogji veten pas kthimit dhe varrimit të mbetjeve të bijve të saj të vranë dhe të djegur nga kriminelët serbë) është hequr dje pasdite me bager nga pronari i tokës, Hasan Zenun Bala. Kështu ka shkruar në "Facebook" shkrimtari Ag Apolloni.

Ai e vazhdon shkrimin se nëna Pashkë është simbol i Kosovës, prandaj heqja e atij guri është një gjest i pamenduar i pronarit. "Lus Qeverinë dhe qytetarët e Kosovës ta mbrojnë këtë simbol, duke e kthyer gurin aty ku ka qenë, në atë arë të Korenicës (Gjakovë). Ekzistojnë dyshime se heqja e këtij guri është bërë për arsye fetare (sepse pronari



është frikësuar se aty mund të ngritët një kishë, pavarësisht se familja e Pashkës e ka siguruar që nuk do të ngritët asnjë kishë

aty), dhe për arsye politike, se s'i paska pëlqy që kryeministri e paska shkelë arën e tij, kur ka bërë homazh të guri. Ai gur nuk

është objekt fetar, as nuk është gurthemel kisha, as që ka të bëjë fare me politikë. Çdo kryeministër në të ardhmen duhet të bëjë homazh tek ai gur. Ai gur është simbol i një tragjedie kombëtare. Ai simbolizon vuajtjen e një nëne shqiptare dhe, njëkohësisht, vuajtjen e një populli, pjesë e të cilit është edhe Hasani që bëri një gjest fisnik kur e lejoi vendosjen e gurit në arën e tij, dhe një gjest të pahijshëm kur e hoqi. Hasan, ne shqiptarët (katolikë dhe muslimanë) ishim viktimë, dhe lufta nuk u bë për arsye fetare. Ai gur është pjesë e kujtesës sonë kolektive kombëtare. Ktheje gurin në vend të vet!", ka shkruar Ag Apolloni. Historia e Pashkë Markut nuk

është e panjohur në Kosovë. Më 27 prill 1999, në masakrën e Mejës, ku ranë 374 martirë, ishin edhe dy djemtë e Pashkës, Gjovalini dhe Milani. Ndonëse dihej se ishin vranë në këtë masakër, trupat e të dyve u cilësuan të zhdukur deri në vitin 2003 kur trupat e tyre u kthyen dhe u rivarrosën. Për katër vjet nëna Pashkë priti me shpresë për kthimin të gjallë të bijve të saj. Ajo madje kishte pohuar se nuk do të jetonte më nëse djemtë e saj nuk ktheheshin të gjallë. Ashtu edhe ndodhi. Më 24 maj 2003 trupat e Gjovalinit dhe Milanit veçse ishin kthyer dhe tash po rivarroseshin. E shpresa e nënës së tyre se ata do t'i ktheheshin të gjallë mori fund.

Vazhdojnë kolonat e gjata në pikën kufitare Dheu i Bardhë, bashkatdhetarët presin deri në pesë orë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kolona të gjata deri në 4 mijë metra janë krijuar në vendkalimin kufitar Dheu i Bardhë të premtën. Mërgimtarët po

detyrohen të presin deri në pesë orë për të hyrë në territorin e Kosovës. Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga Qendra

Kombëtare për Menaxhim Kufitar të publikuar në ora 12:08, kolona tashmë kanë filluar të krijohen edhe në vendkalimin kufitar

Muçibabë. Në pikën kufitare Muçibabë kolonat arrijnë deri 500 metra. Vendkalimet e tjera raportohet të jenë të lira për qarkullim.



Verifikimi i statusit të viktimave të përdhunimit “nuk duhet të ketë” afat

PRISHTINË, 21 KORRIK - Të mbijetuarit e përdhunimeve gjatë luftës në Kosovë tash e sa muaj nuk mund të parashtrijnë kërkesa për ta siguruar statusin e viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës. Sipas ligjit aktual, afati kohor për një gjë të tillë ka skaduar më 5 shkurt.

Në Kosovë nuk dihet saktë numri i personave të përdhunuar gjatë luftës më 1999, por besohet të jetë rreth 20 000. Nga shkurti i vitit 2018, kur ka nisur aplikimi për njohjen e statusit të viktimës, atë e kanë siguruar gjithsej 1 558 veta.

Javën e kaluar Kuvendi i Kosovës i kaloi në lexim të dytë ndryshimet në një ligj të hartuar nga qeveria, i cili, mes të tjerash, trajton edhe statusin dhe të drejtat e personave të përdhunuar gjatë luftës.

Me këtë masë, afati për aplikim është shtyrë për dy vjet, përkatësisht deri më 15 maj 2025, me mundësi zgjatjeje edhe dy vjet. Por, kufizimi nxiti kundërshtimin e disave - nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deri tek organizatat që mbrojnë të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale në luftë. Sipas tyre, afati i aplikimit për këtë status duhet të

jetë i pakufizuar, derisa viktima të ndihet e gatshme për një hap të tillë.

“Nuk jam në gjendje të flas tash për dhunën”

Statusi i viktimës së dhunës seksuale të luftës i siguron asaj një pension prej 230 eurosh në muaj dhe disa përfitime të tjera, si: shërbime shëndetësore falas dhe përparësi në punësim.

Sipas ligjit në Kosovë, i cili është miratuar në vitin 2014, statusi i tillë i takon çdo personi i cili arrin ta bindë një komision qeveritar se ka qenë viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, përkatësisht në periudhën 27 shkurt 1998 - 20 qershor 1999.

Dafina, e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, thotë se edhe 24 vjet pas përdhunimit, nuk mund ta bindë veten që të dalë para një komisioni dhe ta rrëfejë përjetimin e saj. Shprehet e sigurt se një gjë të tillë nuk do të mund ta bëjë as gjatë dy vjetëve të ardhshëm. “Nuk jam në gjendje tash për tash të flas [për dhunën], për arsye të familjes, fëmijëve, sepse jetoj në bashkësi

familjare. Më kanë thënë se janë disa proceduara, komisione dhe kam frikë se mos po zbulohem. Nuk e di, ndoshta pas një kohe... pas katër-pesë vjetësh mund ta bëj një gjë të tillë”, thotë Dafina, identiteti i vërtetë i së cilës është i njohur për redaksinë e REL-it. Dafina thotë se, përveç bashkëshortit, askush tjetër në familjen e saj nuk e di se është përdhunuar.

Pikërisht për këtë - mosgatishmërisë së viktimave për të folur - disa kërkojnë që afati për aplikim për statusin e viktimës të mos ketë kohë të caktuar.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila duhet ta nënshkruajë ligjin për të hyrë në fuqi, ka thënë më 17 korrik se “afati i aplikimit për statusin e viktimës së dhunës seksuale duhet të jetë i pakufizuar”.

Organizata joqeveritare, që mbrojnë të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, kanë kërkuar të njëjtin gjë.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) në Kosovë, bashkë me anëtarë të platformës “Bëhu Zëri Im”, kanë thënë se kufizimi i afatit për aplikim për

njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, është në kundërshtim me konventat dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare.

Sipas praktikave ndërkombëtare, për shembull në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, afati për aplikim për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale në luftë nuk është i kufizuar.

“QKRMT-ja do të vazhdojë ta adresojë nevojën që afati për aplikim të mos kufizohet, por të jetë pa kufi, ashtu siç është adresuar përmes letrave avokuese në Zyrën e Kryeministrit, kryetarit të Kuvendit, grupeve parlamentare dhe komisioneve përkatëse. Kësaj, ligji do të ishte në harmoni me të drejtën dhe praktikat ndërkombëtare, si dhe me nevojat dhe ndjeshmërinë e viktimave që e drejta për njohjen e vuajtjeve të tyre të mos jetë e kufizuar në kohë”, thotë QKRMT-ja në një deklaratë me shkrim dërguar Radios Evropë e Lirë. “Ne insistojmë se nuk duhet të ketë kufizime kohore në ligj”, thotë edhe Kadire Tahiraj, drejtoreshë e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave në Kosovë.

A mund të bëhen ndryshime në ligj?

Kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Kosovës, Duda Bale, thotë se ky organ i ka kërkuar qeverisë të bëjë ndryshime në propozim-ligj, duke mos e kufizuar afatin por, sipas saj, qeveria nuk i ka marrë parasysh kërkesat. “Tash është vonë për [ndryshime]. Unë e respektoj shumë mendimin e presidentes, por tash është vonë, se është votuar në Kuvendin e Kosovës”, thotë Bale.

Presidentja, me autoritetin e saj, mund të mos e nënshkruajë një projektligj të miratuar nga Kuvendi dhe mund ta kthejë atë në Kuvend me vërejtje të caktuara. Por, edhe Kuvendi mund ta kundërshtojë një propozim të presidentes nëse ai ligj hyn sërish në procedurë dhe votohet me 61 vota për.

Kryetarja e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale, Leonora Selmani, thotë se nuk duhet të ketë vonesa në dekretimin e projektligjit të miratuar nga Kuvendi. Sipas saj, mundësitë e tjera rreth afatit do të mund të shikohen më vonë. “Fillimisht duhet të dekretohet ligji ashtu siç është vendosur në Kuvend, mandej është çështje që duhet të diskutohet se a do të duhet të jetë me një afat më të gjatë apo jo. Aktualisht, unë mendoj se duhet të jetë 2+2 [vjet] dhe gjatë kësaj periudhe kohore të mobilizohen të gjithë për të parë se si duhet të veprohë në të ardhmen”, thotë Selmani.

Më herët, disa organizata joqeveritare, përmes të cilave numër i caktuar personash ka aplikuar për statusin e viktimës së dhunës seksuale, kanë shprehur shqetësimin se pritet e gjata për shqyrtimin e rasteve nga Komisioni qeveritar, kanë bërë që shumë viktime të heqin dorë nga aplikimi për statusin që do të mund t’u takonte. Ka pasur raste kur një person ka pritur deri në 17 muaj.

Situatën, sipas tyre, e vështirëson shpesh edhe paraqitja fizike para komisionit, pasi viktimat kanë frikë nga stigmatizimi. Për aplikim, viktime duhet të plotësojë një formular me të dhëna për vendin dhe periudhën kur ka ndodhur përdhunimi, me deklarata nga dëshmitarët dhe me raporte eventuale mjekësore. Nëse komisioni nuk bindet, viktime duhet të dalë fizikisht para tij.



Kuvendi hap dyert për bashkatdhetarët më 24 dhe 25 korrik

Prishtinë, 21 korrik - Të hënën dhe të martën, më 24 dhe 25 korrik, Kuvendi i


Kosovës organizon aktivitetin tradicional “Bashkatdhetarët në Kuvend”. Sipas njoftimit,

të gjithë bashkatdhetarët të cilët dëshirojnë ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës dhe të

takohen me deputetë, janë të mirëpritur nga ora 8:00-16:00.



Kompanitë milionëshe që po i mbajnë të rinjtë në Kosovë



PRISHTINË, 21 KORRIK - Viti 2008 e kishte gjetur Arianit Fazliun nga Prishtina në një udhëkryq. Si student i ndërtimitarisë në Universitetin e Prishtinës, ai e kishte lënë punën e tij të atëhershme në këtë sektor, për t'iu përveshur provimeve të mbetura. Por, edhe sot i ka ende 12 provime të papërfunduara nga gjithsej 45. Kjo, pasi një ditë, 15 vjet më parë, vendosi të merrte një rrugë jo shumë të frekuentuar në Kosovën e atëhershme: në fushën e teknologjisë së informimit dhe komunikimit. Atëherë vetëm 20 vjeç, Arianiti - i cili fillimisht kishte dashur të studioje për farmaci - nuk e kishte të lehtë tentimin e tij të tretë për ta gjetur veten në një karrierë.

Ai nisi të punonte në një kompani të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, "Rrota", pas rekomandimit nga një familjare e tij. "Pata filluar nga zeroja. Në fakt, jo nga zeroja, por nga minusi. Unë nuk e dija as çka është Chrome [platformë kërkimore në internet]. Më është dashur të punoj nga 18 orë në ditë për t'i arritur të tjerët", kujton Arianiti.

Puna e asaj kohe iu shpërblye në vitin 2013, kur ai, së bashku me bashkëpunëtorin e tij, Faton Selishta, formuan kompaninë softuerike "Kutia". "Në fillim, prej rrogës kemi kaluar në pa rroga. Pastaj 100 euro në muaj, 150... varësisht si vinin. Kemi punuar në një banesë, i patëm bërë tavolinat vetë, me këso paleta [druri]", thotë 35-vjeçari për Radion Evropa e Lirë.

"Kutia" - si shumë kompani të tjera të kësaj fushe në Kosovë - vitin e kaluar pati rritje të ndjeshme, prej 159-

përqindësh.

Në katër vjetët e fundit kompanitë e sektorit të teknologjisë informative kanë qarkulluar rreth 465.5 milionë euro. Vlera e qarkullimit vjetor është rritur vit pas viti.

Në krahasim me vitin 2021, numri i kompanive që kishin qarkullim vjetor mbi një milion euro u rrit për katër për qind në vitin 2022.

Kompania "Kutia" eksporton produkte softuerike në ShBA, Norvegji, Suedi, Gjermani e shumë vende të tjera. Sipas një raporti të publikuar këtë muaj nga Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK), edhe pse shumica e kompanive të këtij sektori janë nën pronësi vendore, tregu në Kosovë përbën vetëm 16 për qind të klientëve të këtyre kompanive.

Përdërisa shumica e kompanive në sektorin e teknologjisë informative janë nën pronësi vendore, Kosova përbën vetëm 16 për qind të tregut të tyre. Por, edhe pse kompania e tij është rritur dukshëm dhe tani është zhvendosur në një zyrë të re, Arianiti thotë se ende vazhdon të ofrojë punë për studentët e rinj, me qëllim të "shpërndarjes së dijes". Kompania e tij punëson dhjetëra praktikantë. "Kemi qenë dy [Arianiti dhe Faton] dhe e kemi shpërndarë dijen me të gjithë. Pastaj, ata që kanë qenë më të vjetër, e kanë shpërndarë dijen me të rinjtë. Është bërë një piramidë e shpërndarjes së dijes, e cila ekziston edhe tash", thotë Arianiti.

"Nëse i kthejmë drejt industrisë sonë shumicën e të rinjve, rreth 50 për qind të të

diplomuave, unë jam i sigurt që nga industria jonë, [të rinjtë] nuk do të shkojnë jashtë, të paktën jo për shkaqe financiare", shton ai.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), vetëm gjatë vitit 2021 nga Kosova kanë emigruar gati 43 mijë persona. Një anketë e bërë më 2020 nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) tregon se mbi 48 për qind e kosovarëve donin të migronin. Kjo përqindje ka qenë në trend rritjeje që nga viti 2014.

Arbëresha Loxha, drejtore e ekzekutive e GLPS-së, ka thënë më parë për REL-in se mungesa e perspektivës së punësimit dhe gjendja e vështirë [të mbajmë të rinjtë në Kosovë]. Ne, si kompani private, duhet t'u përmbahemi disa rregullave", thotë Fikreti, kompania e të cilit punëson rreth 2 000 punëtorë në Kosovë, me moshë mesatare prej 29 vjeç.

I rritur në Zvicër, Fikreti tani e kalon gjysmën e kohës në Kosovë. Ai fillimisht kishte shkuar pas fundit të luftës në vitin 1999, e më vonë ishte kthyer me disa ide biznesi. Por, ëndrra e tij u bë realitet vetëm në vitin 2016, kur ai hapi "Speex"-in.

Kompania e tij tani ofron paga dukshëm më të larta sesa mesatarja në Kosovë. Sipas ASK-së, paga mesatare bruto për vitin 2022 ishte 521 euro, ndërsa në "Speex" është 1 200 euro. Edhe kompanitë e tjera të këtij sektori ofrojnë paga të ngjashme.

Fikreti është siguruar që punëtorët e tij të kenë edhe hapësira ku mund të gjejnë paqe. Në ndërtesën e re të kompanisë së tij në Prishtinë, punëtorët kanë hapësira ku mund të pushojnë, dhoma të lutjes, kuzhinë. "Në të ardhmen do ta kenë edhe një bankomat, ashtu që ata të mund t'i përmbushin të gjitha nevojat e tyre brenda ndërtesës. Ne vazhdimisht i pyesim njerëzit se çka u pëlqen në kompani e çka jo dhe këto hapësira marrin shumë pëlqim", thotë Fikreti për Radion Evropa e Lirë.

Këto kushte më të mira pune bëjnë që fusha e teknologjisë së informimit dhe komunikimit të cilësohet si "sektori i vetëm që ka potencialin ta luftojë trendin e emigrimit", thotë Aldo Baxhaku, zyrtar për komunikimin publik në STIKK. Ai thotë se ky sektor ka potencial të bëjë edhe më shumë sesa vetëm t'i mbajë të rinjtë në Kosovë: ai mund ta bëjë Kosovën një vend të njohur në botë për ofrimin e shërbimeve të kësaj fushe.

"Sektori është në rritje në të gjithë botën. Por, Kosova ka këtë avantazhin e të rinjve - 65 për qind është nën 30 vjeç. Kjo do të thotë që ke potencial. Kosovën e favorizon shumë që ka një popullsi të re në mes të Evropës, që vuan nga popullsia e vjetër", thotë ai. Baxhaku thotë se popullsia e

re - me moshë mesatare prej 35 vjeç - përbën avantazh pasi që sektori dominohet nga të rinjtë në të gjithë botën dhe aftësitë kompjuterike që kërkohen në këtë sektor, janë aftësi që kryesisht zotërohen nga të rinjtë.

Por, Baxhaku shton se, për ta shfrytëzuar këtë avantazh, Kosova duhet të specializohet në njërin nga fushat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit, si inteligjencë artificiale, siguri kibernetike, zhvillim softuerik etj.

Ngjashëm mendon edhe Arianiti nga Kutia. "Unë shpresoj dhe dëshiroj që Kosova të jetë një vend ku, për shembull, ke inxhinierë të inteligjencës artificiale apo ndonjë fushe tjetër. Në atë mënyrë që kur të vijë klienti i huaj, ta dijë që ju jeni ekspert i asaj fushe dhe të mos e ketë telashe të paguajë aq sa paguan kudo në botë", thotë Arianiti.

Për Vigan Dishën, këshilltar ekzekutiv i bordit drejtues të "Speex"-it, Kosova tashmë është bërë një vend i njohur në botë për shërbimet e kësaj fushe. "Kosova është një destinacion atraktiv për këto shërbime. E kemi dëshmuar që kombinimi i kostos [së ulët] dhe kualitetit [të lartë] e favorizon Kosovën në tregun ndërkombëtar", thotë ai.

Aktualisht në Kosovë janë 1 950 kompani që ofrojnë shërbime të teknologjisë informative dhe komunikimit, në krahasim me 930 sa kanë qenë para pandemisë Covid-19. Rritja më e madhe e sektorit ndodhi vitin e kaluar, kur u shtuan mbi 700 kompani të reja. Gjatë kësaj periudhe është rritur edhe numri i punëtorëve në këtë sektor.

UNË DHE BABAI

Nga: Pär LAGERKVIST
(fitues i Çmimit Nobel për
Letërsi më 1951)
Përktheu nga suedishtja:
Qerim RAQI

Kur isha rreth dhjetë vjeç, më kujtohet, babai më kapi për dore një të diel pasdite dhe dolëm në pyll për ta dëgjuar këngën e zogjve. U përshëndetëm me nënën, e cila duhej të qëndronte në shtëpi për ta gatuar darkën, prandaj nuk na u bashkua. Dielli po shkëlqente ngrohtë dhe ne ishim në rrugë të mbarë. Nuk e morëm aq solemnisht këtë me këngën e zogjve, sikur diçka veçanërisht e këndshme apo e çuditshme, ne ishim njerëz të arsyeshëm, si babai, ashtu edhe unë, të edukuar dhe të mësuar me natyrën. Kjo nuk bënte ndonjë bujë të madhe për ne. Ishte vetëm sepse ishte e diel pasdite dhe babai ishte i lirë. Po ecnim në linjën hekurudhore, ku askush tjetër nuk lejohet të shkonte, por babai ishte mësuar me rrugën pranë hekurudhës dhe e zotëronte atë. Në këtë mënyrë edhe ne u futëm në pyll. Nuk u desh të bënim asnjë kthesë. Së shpejti filloi edhe kënga e shpendëve dhe gjithçka tjetër; cicërima brenda shkurreve të fokave dhe zogjve këngëtarë, harabelave dhe mëllenjave, gjithë zhurma e tyre që të rrethon sapa hyni në pyll. Toka ishte e trashë me lulebore, mëshëknat tani kishin bleruara dhe bredhat ishin lëshuar lastarë të freskët. Vinte erë nga të gjitha anët dhe skutat. Në anën e poshtme shtrihet fundi i pyllit që avullonte nga dielli sipër. Kudo ku kishte jetë dhe zhurmë, nga vrimat e tyre fluturonin grerëzat, mushkonjat vërshonin nga qielli dhe nga shkurret zogjtë lëshoheshin si fshëkë për t'i kapur dhe zhyteshin përsëri shpejt. Papritur erdhi një tren duke zhurmuar dhe ne zbritëm në argjinaturë. Babai e përshëndeti lokomotivistin me dy gishta ngritur mbi kapelë, edhe lokomotivisti e përshëndeti babanë me dorë. E tëra ndodhte shpejt. Më pas u nisëm drejt shinave që ishin djersitur në kataranin e tyre nën rrezet e diellit. Mbante erë gjithfarë, vaj vagonësh dhe lule bajame, katrani dhe shqope dhe gjithçka tjetër. Ne bëmë hapa të mëdhenj në hekurudhë dhe jo në zhavor, që ishte i ashpër për të ecur dhe na i griste këpuçet. Binarët shkëlqenin në diell. Në të dyja anët e linjës kishte shtylla të telefonit që këndonin derisa kalonim pranë tyre. Po, ishte një ditë e bukur. Qielli ishte mjaft i kthjellët, nuk dukej asnjë re, as nuk mund të kishte ndonjë re në këtë ditë, sipas asaj që tha babai. Pas ca çastesh ne erdhëm të një arë me tërshëre në të djathtë të linjës, ku një bujk që e njihnim kishte një luadh. Tërshëra



ishte e dendur dhe kallinjë ishin rritur në mënyrë të barabartë. Babai i largonte me dorë dhe dukej se ishte i kënaqur. Thjesht nuk kuptoja shumë gjëra nga këto, sepse kam lindur në qytet. Kështu ne erdhëm tek ura mbi një përrua ku zakonisht nuk ka shumë ujë, por tani rrjedha ishte e plotë. I mbanim dorën njëri-tjetrit që të mos binim mes binarëve. Më pas nuk kaloi shumë kohë para se të arrinim në shtëpizën e rojeve, e cila është tërësisht e mbuluar me gjelbërim, me mollë dhe shkurre. Aty hymë dhe vizituam. Na qerasën me qumësht. I pamë derrat e tyre, pulat dhe pemët në lulëzim, pastaj e vazhduam rrugën tonë. Ne donim të shkonim te përroi i madh, sepse ishte më i bukur si kudo tjetër, kishte diçka të veçantë, sepse atje më lart në fshat kalonte kah shtëpia e fëmijërisë së babait tim. Nuk na pëlqente të ktheheshim derisa arrinim deri këtu. Madje edhe sot mbërritëm këtu pas një shëtitjeje të mirë. Ishte afër stacionit tjetër, por nuk shkuam deri aty. Babi vetëm donte të sigurohej që semafori ishte mirë. Ai i mendonte të gjitha. Ndalua buzë përroi. Rrjedha zhurmonte miqësisht me rrezen e diellit. Përgjatë brigjeve varej pylli i harlisur gëtherenës dhe reflektohej në ujën e levës. Gjithçka ishte e ndritshme dhe e freskët këtu. Nga liqenet e vegjël më lart vinte një erë e vogël. Ne zbritëm nga shpati dhe ecëm pak përgjatë bregut.

por kishte qenë një realitet i bekuar. Tani ai nuk kishte kohë. Kështu që ne shkonim përreth duke fërshëllirë për një kohë të mirë nëpër vijën bregdetare, nxirrëm copalëvoresh të halorëve që rryma i merrte me vete dhe hidhnim guralecë në ujë për të parë se kush gjuante më larg. Ne për nga natyra, si babai ashtu edhe unë, ishim të lumtur dhe të hareshëm. Më në fund, u lodhëm dhe menduam se kishim qëndruar mjaft aty dhe u nisëm për në shtëpi. Pastaj filloi të errësohej. Pylli kishte ndryshuar. Nuk ishte ende errësirë, por nxitua. Nëna duhet të ketë qenë e shqetësuar derisa na prishte për të ngrënë. Ajo gjithmonë kishte frikë se diçka do të ndodhte. Por, për ne ishte një ditë e mrekullueshme. Asgjë nuk na ndodhi. U kënaqëm me gjithçka. Po errësohej edhe më. Pemët ishin shumë të çuditshme. Ato qëndronin dhe i bindeshin çdo hapi që hidhnim, sikur të mos dinin se kush ishim. Një pemë aty kishte një xixëllonjë brenda trunqut. Qëndronte duke na i ngulur sytë poshtë në errësirë. Unë i shtrëngova dorën babait, por ai nuk e pa atë shkëlqim të çuditshëm, vetëm vazhdoi të ecte. Ndërkohë arritëm tek ura mbi përrua. Nga thellësia aty dëgohej zhurma e përroit. E frikshme, që sikur donte të na gllabëronte, që sikur do të hapej një humnerë poshtë nesh. Shkelnim me kujdes traversat, duke ia mbajtur njëri-tjetrit fort dorën që të mos rrëzoheshim. Unë mendova se babi do të më mbante në shpinë, por nuk tha asgjë, mbase donte që unë të isha si ai dhe të mos mendoja se kishte ndonjë rrezik.

Vazhduam. Babai kalonte urën aq qetë, me hapa të sigurt, në errësirë, i qëndrueshëm, pa folur, mendonte me vete. Nuk mund ta kuptoja se si mund të ishte kaq i qetë kur ishte aq errët. Shikoja përreth i frikësuar. Kudo mbretëronte vetëm errësirë. Mezi guxoja të merrja frymë thellë, sepse atëherë mund ta fusja brenda meje errësirën dhe kjo ishte e rrezikshme. Mendoja se së shpejti do të vdisja. Më kujtohet mirë se këtë e besoja në atë kohë. Argjinatura zbriste pjerrtas, si në humnerat e zezat të natës. Shtyllat e telefonit ngriheshin fantazma deri në qiell, gjëmonin lehtë brenda tyre, sikur dikush të fliste thellë në tokë. Plisat e bardhë prej porcelani qëndronin tmerrësisht të struktur dhe i bindeshin kësaj. Gjithçka ishte e tmerrshme. Asgjë nuk ishte e vërtetë. Gjithçka ishte si një mrekulli. Iu afrova babait dhe i pëshpërita:

- Babi, pse është kaq tmerrshëm në errësirë?
- Jo, biri im i dashur, errësira nuk është e tmerrshme, tha dhe ma shtrëngoi dorën.
- Po baba, është.
- Jo biri, nuk është mirë të mendosh kështu. Ne e dimë se ekziston Zoti. Ndiheha kaq i vetmuar, i braktisur. Ishte shumë e çuditshme se vetëm unë kisha frikë, jo babai. Nuk mendonim njësoj. Dhe e çuditshme ishte se atë që e tha babai nuk më ndihmoi, kështu që unë të duhej të kisha më frikë. As ajo që tha për Zotin nuk më ndihmoi. Edhe unë mendoj se ishte e tmerrshme. Ishte e tmerrshme që ai ishte kudo në errësirë, poshtë trenit, në shtyllat e telefonit që gjëmonin – me siguri ishte ai – kudo. Megjithatë, nuk mund ta shihje

kurrë. Ecnim në heshtje. Secili mendonte për të vetën. Zemra ime tkurrej sikur errësira të kishte hyrë brenda saj dhe ka filluar ta përqafoje. Pastaj, kur ishim në një kthesë, papritmas dëgjua një bubullimë të madhe pas nesh! Ne u befasuam nga mendimet tona. Babi më tërhoqi poshtë argjinaturës, poshtë në humnerë, më mbajti atje. Më pas kaloi treni. Një tren i zi kaloi me shpejtësi maramendëse. Çfarë ishte ky tren. Nuk duhej të kishte tren tani. Shikuam të frikësuar njëri-tjetrin. Zjarri u ndez në lokomotivën e madhe ku hidhnim qymyr me lopata. Shkëndijat gjëmuar egërsisht nëpër natë. Ishte e tmerrshme. Shoferi qëndronte aty i zbehtë, i palëvizshëm, me tipare si të ngurtësuar, i ndriçuar nga zjarri. Babai nuk e dinte se kush ishte, vetëm shikonte përpara, sikur po shkonte brenda errësirës, e cila nuk kishte fund. I ndjekur, i gulçuar nga ankthi, unë qëndrova duke vrojtuar pamjen e egër. Imazhin e përpiu nata. Babai më mori në pistë, nxitua për në shtëpi. Më tha: – E çuditshme çfarë lloj treni ishte! Nuk e njoha shoferin.

Pastaj eci në heshtje. Unë po dridheshja i tëri. Kjo e tëra ishte bërë për mua, përdëshirëtime. E mora me mend se çfarë do të thoshte. Ishte ankthi që do të vinte, tërë e panjohura, ajo për të cilën babai nuk dinte asgjë, nga e cila nuk do të mund të më mbronte. Kështu do të ishte kjo botë për mua, kjo jetë, jo si e babait, ku gjithçka ishte e sigurt dhe e njohur. Nuk ishte një botë e vërtetë, një jetë e vërtetë. Vetëm depërtonte djegëshëm brenda errësirë që nuk kishte fund. /Revista "Akademia"/Telegrafi/



EURO GLASS
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



'Dardanët' U18 në grup me Maqedoninë e Veriut, Zvicrën dhe Sllovakinë

PRISHTINE, 21 KORRIK - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll (djemtë) i ka mësuar të premten kundërshtarët e kualifikimeve për "Euro

2024". Hendbollistët e rinj të Kosovës do të garojnë në Grupin B, ndërsa kundërshtarë do t'i kenë Maqedoninë e Veriut, Zvicrën dhe Sllovakinë. Dy të

parët në grup kualifikohen në Kampionatin Evropian që vitin tjetër mbahet në Mal të Zi. Kombëtarët që përfundojnë në pozitë tre e katër do të garojnë në

Evropianin e Divizionit II. Ndeshjet pritet të luhen në Maqedoni të Veriut, e cila e ka të drejtën e organizimit të turneut të Grupit B, sipas shortit.



Juniku dhe Peja e mbështetin fuqishëm Robin Krasniqin

"Epoka e re"

PEJË, 21 KORRIK - Ndalesa e tretë e karvanit të autobusit të Robin Haxhi Krasniqi ka qenë në Junik dhe Pejë. Vendlindja e kampionit të boksit, me organizim të kryetarit të Junikut, Ruzhdi Shehu, ka organizuar në amfiteatrin e asamblesë së komunës ceremoninë e shfaqjes së dokumentarit dhe paraqitjes së ekspozitës. Të pranishmit me vëmendje e kanë ndjekur dokumentarin, i cili reflekton emocion, përmes vuajtjeve dhe sakrificës në rrugën drejt titujve të Robin Krasniqit. Kryetari i komunës, Ruzhdi Shehu, ka thënë se 5 gushti do të jetë ditë e



madhe. "Robin Krasniqi i urojmë suksese dhe i themi se jemi me ty në këtë ndeshje. Besojmë dhe shpresojmë se

fitorja është e sigurt", ka thënë i pari i Junikut, Ruzhdi Shehu. Anëtar i Këshillit Organizativ, Behar Mehmeti, i ka falënderuar

të gjithë për këtë organizim, duke shtuar se "mikpritja është virtyt i Dukagjinit dhe s'gjë fjalë ta përshkruaj. Faleminderit nga zemra".

Në mbështetje të Robin Krasniqit ka dalë edhe zyrtari i komunës së Junikut, Artan Krasniqi. Ai shtoi se ishte kënaqësi që komuna e Junikut e pati rastin ta mirëpresë karvanin. "Siç e tha edhe boksieri ynë Robin Haxhi Krasniqi, nuk do të boksojë në Gjermani, por janë mbledhur të gjitha shqiptet për ta mbështetur", ka shtuar Krasniqi. Pas Junikut, karvani të mërkurën vazhdoi në Pejë. Autobusi është ndalur në qendër, ku aty patën rastin

qytetarë të shumtë dhe tifozë të Robinin ta përcjellin nga afër dokumentarin dhe ekspozitën. "Jam i nderuar që karvani i Robin Krasniqit është në Pejë. Me datën 5 gusht është një betejë e madhe. I dëshirojmë sukses e me fitore", ka thënë kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri. Në Pejë e Junik u shpalo edhe një befasi e mbrëmjes së 5 gushtit, ku u bë e ditur prania e solistes së njohur Dafina Zeqiri, në një prej performancave artistike që do t'i ketë kjo ngjarje. Në qytetet e tjera do të shpalesen edhe befasi të tjera të eventit me emra të njohur nga estrada, që do të paraqiten në skenën e 5 gushtit në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Projekti i ndërtimit të fushave po zbatohet me ritëm të shpejtë

PRISHTINE, 21 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës me shumë përkushtim po vazhdon implementimin e projekteve të cilat janë paraparë të realizohen brenda ciklit katërvjeçar. Si një nga më të rëndësishmit është projekti për zhvillimin e infrastrukturës në bashkëpunim me komunat, i cili ka gjetur zbatim të mirë në praktikë. Pas memorandumeve të nënshkruara në mes të krerëve ndërinstitucionalë, punët janë kryer me intensitet të shpejtë. Projekti në bashkëfinancim me komunat, e i cili është mbështetur nga programi UEFA HaTrick,

është paraparë të realizohet në të gjitha regionet e Kosovës. Qëllimi i këtij projekti është t'u ofrojë të rinjve nga mbarë Kosova hapësira sportive, përkatësisht fusha të futbollit bashkë me objektet përcjellëse, në të cilat ata do të mund ta aplikojnë lojën e futbollit, të zhvillohen kategoritë e reja dhe të mundësohet një përfshirje sa më e madhe e fëmijëve të të dy gjinive në këtë sport. Gjatë një periudhe të shkurtër është arritur të punohet për realizimin e këtij projekti në disa vende. Fushat me bari sintetik në qytete të ndryshme të Kosovës thuajse kanë përfunduar,



ndër to janë fusha në Brestovik të Pejës, e cila është në fazën finale, ashtu siç është edhe ajo në Gjonaj

të Prizrenit, ku po punohet tashmë e cila është në fazën finale, ashtu siç është edhe ajo në Gjonaj

Ndërsa në Zhur dhe në Dragash faza e parë e punimeve ka përfunduar, derisa shumë shpejt do të fillohet faza e dytë. FFK synon ta vazhdojë këtë projekt edhe me komunat e tjera për të mundësuar që çdo vend ku ka më shumë se 25 lojtarë që luajnë dhe e praktikojnë futbollin të ndërtohet një fushë. Nëpërmjet këtij projekti të rinjtë do të kenë mundësinë t'i shfrytëzojnë hapësirat sportive të reja dhe ta ndjekin pasionin e tyre për futbollin, në të njëjtën kohë do të rritet ndjeshmëria sociale dhe ekonomike në komunitetet ku ky projekt do të realizohet.

KB Trepça në kualifikimet e FIBA Europe Cup

MITROVICË, 21 KORRIK - Fituesja e Kupës së Kosovës, KB Trepça, do të marrë pjesë në kualifikimet e FIBA Europe Cup. Gjashtë nga turnet do të përbëhen nga tre ekipe me një turne të përbërë nga katër ekipe, pra gjithsej do të jenë shtatë turne që zhvillohen nga 3 deri më 5 tetor. Formatit i sheh skuadrat që luajnë me

njëri-tjetrin dhe fituesi i turneut kalon në grupet e edicionit të rregullt. Shorti për edicionin e rregullt dhe kualifikues të FIBA Europe Cup do të hidhet në Mumihi të Gjermanisë të martën më 8 gusht. Gjithsej 35 klube që përfaqësojnë 23 Federata Kombëtare u regjistruan për të marrë pjesë në edicionin e

nëntë të kompeticionit. Prej tyre, 13 klube janë vendosur direkt në edicionin e rregullt, ndërsa 22 klubet e mbetura do të garojnë në kualifikues. Mitrovicasit ishin organizatorë në vitin e kaluar të njërit nga grupit kualifikues, ku në fund u kualifikua Sportingu i Lisbonës.



Asllani: Synojmë titullin kampion

MILANO, 21 GUSHT - Pas një sezoni të parë kur pati hapësira të limituara në dispozicion, Kristjan Asllani rikthehet me të tjera objektiva tek Interi, këtë herë për të luajtur shumë më tepër dhe për t'i treguar cilësitë për të

cilat zikaltrit e blenë nga Empoli. "Është gjithmonë kënaqësi të rikthehesh dhe t'i takosh shokët. Më mungonte fusha kur isha me pushime dhe jam shumë i lumtur që kemi nisur përgatitjet për një tjetër sezon. Vitin e kaluar

punova shumë dhe shokët e skuadrës më ndihmuan shumë për t'u përmirësuar, ndaj tani jam gati të marr më shumë përsipër", u shpreh Asllani. Mesfushori i talentuar shqiptar nuk ngurroi të shpalosë edhe objektivat e

zikaltërve, që sezonin e kaluar shkuan deri në finalen e Ligës së Kampionëve. "Këtë sezon kemi si objektivi të fitojmë titullin kampion. Kemi nisur përgatitjet dhe do të vijojmë të punojmë shumë për t'ia dalë", ka deklaruar Asllani.



Zulfiu: Rijeka ka kualitet, por në futboll gjithçka është e mundur

KLINË, 21 KORRIK - Sulmuesi anësor nga Miratoca e Preshevës, Iljasa Zulfiu, i njohur ndryshe edhe si "Caja", ka folur në një intervistë për "Telegrafin", ku ka treguar ndjenjat e tij për kalimin historik të Dukagjinit në raundin e dytë të Ligës së Konferencës, por edhe për ambientimin e tij me klubin klinas, ndeshjen e radhës në Evropë ndaj Rijekës dhe ëndrrën e tij të madhe. Dukagjini ka arritur të sigurojë kalimin në raundin e dytë të Ligës së Konferencës pas fitoreve në dy ndeshjet ndaj Europa FC të Gjibraltarit. Një nga më meritoret për kalimin tutje të klinasve, ishte sulmuesi anësor Iljasa Zulfiu, i cili në ndeshjen e parë në Prishtinë shënoi në minutat shtesë golin e fitores 2-1, ndërsa dje (e enjte) në udhëtim shënoi dy gola. Pas fitores dhe kalimit në raundin e dytë, Zulfiu ka treguar se ndihet shumë i kënaqur pasi po bëjnë histori me klubin nga Klinë, në të cilin është pritur shumë mirë nga të gjithë dhe po kalon momente të mira. "Jemi shumë të kënaqur si unë gjithashtu edhe ekipi sepse ishte kalim historik për Klubin e Dukagjinit", ka thënë fillimisht



Zulfiu. "Kam bërë tash 1 vit dhe ndihem shumë mirë, pasi kam gjetur një ambient shumë të mirë si me pjesëtarët e klubit, si me bashkëlojtarët".

"Caja" ka folur edhe për kundërshtarin e ardhshëm të Dukagjinit, gjigantin kroat Rijekën, të cilin e vlerëson shumë, por thotë se do të hyjnë për rezultat pozitiv. "Shpresoj që me Rijekën të marrim një rezultat pozitiv edhe pse e dimë që Rijeka ka kualitet. Por, në futboll gjithçka është e mundur dhe ne si ekip do ta japim maksimumin". Në fund, 25-vjeçari nga Miratoca e

Preshevës ka folur edhe për ëndrrën e madhe për të luajtur te ndonjë klub evropian. "Edhe unë si çdo lojtar ëndërroj të dalë në Evropë të luaj me ndonjë klub evropian. Shpresoj që një ditë Zoti të ma plotësojë dëshirën. Por, jo vetëm mua, por çdonjërit", përfundoi ylli i Dukagjinit. Dukagjini ndeshjen e radhës në raundin e dytë të Ligës së Konferencës do ta zhvillojë me datë 27 korrik nga ora 19:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, ndërsa atë kthyesë më 3 gusht nga ora 20:15.

Spanja përgatitet për dyshen e ëndrrave, Alcarazi fton Nadalín të luajnë bashkë në Olimpiadë

MADRID, 21 KORRIK - Ka ardhur momenti që Spanja të ëndërrojë. Tashmë që karriera e Rafael Nadalín është në fund, ndërkohë që sapo ka nisur ajo e Carlos Alcaraz, të gjithë shpresojnë të shohin duke luajtur së bashku dy kampionët spanjollë të tenisit. Dhe ku ka më mirë se kjo gjë të ndodhë në "Paris 2024". Nadali ka mbyllur sezonin për shkak të problemeve fizike, duke konfirmuar se do të rikthehet në fund të këtij viti ose janar 2024. Ai që ka zgjuar ëndrrën e spanjollëve dhe të tijen është Alcarazi, që synon të luajë me Nadalín në fushat me dhe të Parisit pas një viti, përgjatë Olimpiadës. "Do të ishte një ëndërr që bëhet realitet. Jo vetëm



të fitojë në Olimpiadë një medalje të artë në lojën teke, por edhe atë në lojën dyshe, duke e pasur Nadalín në krah. Do të ishte një përvojë e paharrueshme të përjetosh një ëndërr të tillë me idhullin tënd. Do të ishte një kujtim që do ta mbaja përgjithnjë

me vetë", ka thënë Alcaraz. Nadali dhe Alcarazi janë përballur tri herë në karrierë, me veteranin që ka fituar dy herë, por numri 1 në botë ka fituar sfidën e fundit një vit më parë. Së fundi, Nadali e ka përgëzuar patriotin e tij për triumfin në Wimbledon.

SHKURT

Fenerbahçe interesohet për Vojvodën

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Mërgim Vojvoda, mund të ndryshojë skuadër në këtë afat kalimtar. Anëtarin e Torinos në Itali po e kërkon skuadra e madhe turke, Fenerbahçe. Sipas medieve italiane, klubi i madh turk ka shprehur interesimin për transferimin e tij dhe e ka kontaktuar me skuadrën e Torinos. Ende nuk dihet qëndrimi i klubit italian për futbollistin nga Drenica.

Verstappen: Në Hungari do të kemi të tjera risi

Piloti holandez Max Verstappen, i shkëputur 99 pikë nga ndjekësi më i afërt, shoku i tij i skuadrës (Sergio Perez), përgatitet për garën e radhës që zhvillohet këtë fundjavë në Hungari. Kampioni i botës në Formula 1 shpreson në një tjetër fitore, në një sezon ku ai dhe Red Bulli po dominojnë në çdo pistë. Verstappen nuk heq dorë nga fitorja, teksa konfirmon se për në këtë pistë Red Bulli vjen me disa modifikime që do ta bëjnë edhe më të shpejtë. "Kemi disa risi gati për këtë fundjavë dhe shpresojmë që ato të funksionojnë ashtu sikurse presim. Të shohim se si do të shkojë makina në një pistë shumë teknike", ka thënë Verstappen.

"Këtu kthesat janë me shpejtësi të vogël, një pistë shumë impenjuese për pilotët dhe gomat. Nëse gjërat e reja do të funksionojnë mirë, atëherë do të jemi edhe më të shpejtë karshi rivalëve. Shpresojmë ta vijojmë serinë pozitive, pasi kemi një makinë të jashtëzakonshme, që synon fitoren në çdo garë", ka shtuar holandezi.

Edhe Alba shkon tek Inter Miami

Ish-mbrojtësi i Barcelonës, Jordi Alba, do ta vazhdojë karrierën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me ekipin e Inter Miami. Kjo u bë e ditur nga vetë Inter Miami, teksa spanjollit do të jetë pjesë e klubit nga MLS përgjatë sezonit 2023/24. Aty Jordi Alba do t'i gjejë ish-bashkëlojtarët, Lionel Messi dhe Sergio Busquetsin.

De Gea refuzon Interin, pëlqen Atletico ose Arabinë Saudite

David De Gea është larguar nga Manchester Unitedi pas përfundimit të kontratës. Interesim për portierin spanjoll ka shfaqur Interi, skuadër e cila ka mbetur pa portierin Andre Onanan, i cili u bashkua Unitedit. Mediet britanike raportojnë se De Gea nuk është i interesuar për t'u bashkuar Interit që e refuzoi edhe ofertën prej 5 milionë eurosh në vit dhe më shumë pëlqen rikthimin te Atletico Madridi. Opsion për portierin spanjoll është edhe transferimi në Arabinë Saudite, te disa klube që kanë shfaqur interesim për të. Nëse kalon në këtë lig, De Gea do të bëhet portieri me rrogën më të lartë në botë.

PSG-ja bën çmendurinë për Mbappen

Paris Saint-Germain besohet se ka bërë një ofertë marramendëse për Kylian Mbappen. Sipas mediave "Defensa Central", PSG i ka bërë një ofertë të pabesueshme Mbappes, me

një kontratë 10-vjeçare në tavolinë me vlerë 1 miliard euro. Kjo do ta lidhte Mbappen me klubin deri në moshën 34-vjeçare dhe si thelb do të funksiononte si një marrëveshje e

përjetshme. Do të ishte gjithashtu kontrata sportive më fitimprurëse në histori. Megjithatë, Mbappe raportohet se i ka thënë PSG-se se ai nuk është i motivuar nga paratë dhe ëndërron të

luajë për Real Madridin, ku mund të fitojë çdo trofë të mundshëm që ofrohet. Sulmuesi tashmë i ka thënë klubit se nuk ka ndërmend të nëshkruajë një marrëveshje të re dhe

planifikon të largohet si transferim i lirë verën e ardhshme. PSG-ja e ka njoftuar futbollistin se ai ose duhet të nëshkruajë një marrëveshje të re ose të shitet këtë verë.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FITESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 07-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimin më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

Dosja për: Kontratë për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uecin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **02.08.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **04.08.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **04.08.2023 ora 14:00.**



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Sullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albert Dina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – IX - SHFMU "Faik Konica" Celinë.

- Besmir Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI –IX- SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

- Durim Lubiceva shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

